

**VENDIM**  
**Nr. 896, datë 18.11.2020**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË  
REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR BASHKËPUNIM DHE NDIHMË TË  
NDËRSJELLË, NË RASTE TË FATKEQËSIVE NATYRORE DHE TË  
FATKEQËSIVE TË TJERA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunim dhe ndihmë të ndërsjellë, në raste të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**

**MARRËVESHJE**

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR BASHKËPUNIM DHE NDIHMË TË  
NDËRSJELLË, NË RASTE TË FATKEQËSIVE NATYRORE DHE TË FATKEQËSIVE  
TË TJERA**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, më poshtë të quajtura “Palët”,

të bindura për domosdoshmërinë e bashkëpunimit bilateral, në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, në të mirë të rritjes së sigurisë kombëtare dhe rajonale, sigurisë së jetës së shtetasve të dy vendeve, gjësë së gjallë, pronës, trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, si dhe për një ambient më të sigurt për të gjithë qytetarët e vendeve të tjera që kalojnë në vendet tona;

duke marrë në konsideratë pozitën gjeografike, rreziqet e përbashkëta që kërcënojnë të dyja vendet, por edhe kapacitetet e pamjaftueshme për të përballuar të vetme fatkeqësitë e mëdha;

të vetëdijshëm se shkëmbimi i informacionit me karakter shkencor dhe teknik në fushën e parandalimit të fatkeqësive është me interes të përbashkët;

të bindur, gjithashtu, në domosdoshmërinë për bashkëpunim ndërmjet Palëve, me qëllim dhënien e ndihmës së ndërsjellë dhe lehtësimin e kalimit të ekipeve dhe të pajisjeve të ndihmës në raste të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera;

duke u bazuar në ligjin nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të Republikës së Shqipërisë;

duke u bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë nr. 502, datë 13.9.2017, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar;

duke u bazuar në ligjin nr. 04/L-230, “Për Agjencinë e menaxhimit emergjent”, të Republikës së Kosovës;

Duke u bazuar në ligjin nr. 04/-L-027, “Për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera”, të Republikës së Kosovës,

bien dakord për sa më poshtë.

## Neni 1

### Qëllimi i marrëveshjes

1. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është që palët, brenda mundësive të tyre, të ndihmojnë njëra-tjetrën në rritjen e kapaciteteve, si dhe në reagimin në raste të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera kur Pala kërkuese, me kapacitetet që ka, nuk mund të menaxhojë plotësisht pasojat e fatkeqësisë;

2. Palët në këtë Marrëveshje, brenda kuadrit ligjor të tyre, do të jenë të gatshme për të ndihmuar dhe për të bashkëpunuar në fushën e Mbrojtjes Civile, në veçanti, lidhur me:

a) planifikimin dhe masat parandaluese për t'u mbrojtur nga rrëshqitjet e tokës, tërmetet, vërshimet/përmytjet, rënia e borës së madhe, zjarret në pyje, rreziqet teknologjike, epidemitë, si dhe fatkeqësi të tjera që vijnë nga veprimtaria njerëzore dhe që mund të ndikojnë në territorin e njërës nga Palët;

b) ndihmë të ndërsjellë në mbrojtjen, kërkim-shpëtimin dhe eliminimin e pasojave që vijnë nga fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera;

c) trajnimin dhe ushtrimin e strukturave operationale të palëve, të cilat angazhohen për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

## Neni 2

### Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

“Pala kërkuese” do të jetë Pala bashkëpunuese në këtë Marrëveshje ose institucioni i autorizuar prej saj, që kërkon ndihmë nga Pala tjetër bashkëpunuese bazuar në këtë Marrëveshje.

“Pala ndihmuese” do të jetë Pala bashkëpunuese në këtë Marrëveshje, që do t'i përgjigjet Palës Kërkuese për ndihmë.

“Vendi tranzit” nënkupton territorin e një pale tjetër që nuk përfshihet në këtë marrëveshje, ku ekipet e ndihmës ose ndihma dhe pajisjet do të kalojnë, për nevojat e njërës prej palëve të kësaj marrëveshjeje.

“Fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësitë e tjera (këtu të referuara si “fatkeqësi”) do të thotë një ngjarje apo një sërë ngjarjesh që kanë ndodhur si pasojë e fenomeneve natyrore, incidenteve, aksidenteve apo rrethanave të tjera të jashtëzakonshme, përveç gjendjes së luftës, të cilat ndikojnë në ose rrezikojnë jetën apo shëndetin e popullsisë, pasurinë ose mjedisin në një masë që kërkon marrjen e masave apo dislokimin e njësive të specializuara dhe përdorimin e pajisjeve të veçanta.

“Shpëtimi” kuptohet tërësia e shërbimeve të bashkërenduara të të gjitha strukturave, që me ligj ngarkohen për shpëtimin e jetës së njerëzve, mbrojtjen e pronës, mjedisit dhe trashëgimisë kombëtare, të cilat rrezikohen apo preken nga fatkeqësitë e ndryshme.

“Ndhimë - dhënia e ndihmës” nënkupton ndihmën e ofruar nga ekipet e shpëtimit, ekspertët, pajisjet apo ndihma humanitare dhe çdo veprim tjetër me qëllim eliminimin e pasojave të menjëhershme apo anësore që vijnë fatkeqësitë.

“Ekipet e shpëtimit dhe ekspertë që marrin pjesë në dhënien e ndihmës” është personeli i trajnuar apo grupe ekspertësh të specializuar dhe të pajisur për të ndërhyrë në fusha të caktuara, ofruar nga Pala ndihmuese.

“Pajisje” do të thotë materiale, mjete teknike dhe transporti, barna dhe pajisje mjekësore dhe pajisje individuale të anëtarëve të ekipit të shpëtimit dhe/ose ekspertëve.

“Ndhimë humanitare” përfshin ndihmën për sigurimin e kushteve minimale për jetesë, si dhe për strehim të përkohshëm, ushqim, veshmbathje, ujë, barna, materiale higjienike dhe bazë ushqimore për bagëti.

“Autoritet kompetent” nënkupton organin përkatës të çdo Pale për të menaxhuar dhe për të bashkërenduar aktivitetet në bazë kësaj Marrëveshjeje.

### Neni 3

#### **Autoritetet kompetente dhe pikat e kontaktit**

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, Palët do të bashkëpunojnë drejtpërdrejt brenda kompetencave të veta, në bazë të legjislacionit të tyre kombëtar.

2. Autoritetet kompetente në bazë të kësaj Marrëveshjeje janë:

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (Autoriteti)

Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës Agjencia e Menaxhimit Emergjent (Autoriteti)

3. Gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente të Palëve, siç përcaktohet në paragrafin 2 të këtij neni, do të autorizohen për të hyrë menjëherë në kontakt të drejtpërdrejtë.

4. Palët do të informojnë njëra-tjetrën për rreziqet, kërcënimet, mundësinë e përhapjes, ndodhjes së fatkeqësisë natyrore dhe fatkeqësive të tjera, që mund të kërcënojnë ose të ndikojnë në njërin prej Palëve.

5. Në rast të ndodhjes së fatkeqësisë, informacioni të jetë në formë raporti i cili duhet të përmbajë: vlerësimin e rrezikut, përshkrimin e fatkeqësisë, të dhëna për vendin, kohën, intensitetin dhe pasojat e saj, masat e ndërmarra, mbështetjen e kërkuar dhe prioritetet lidhur me ndihmën që kërkohet.

6. Raporti mund të jepet me shkrim ose me gojë. Raporti i dhënë gojarisht duhet të konfirmohet me shkrim në jo më vonë se 3 (tri orë).

7. Palët e kësaj Marrëveshjeje do të caktojnë një ose disa pika kontakti, me qëllim të njoftimit dhe shkëmbimit të informacionit në rast fatkeqësie. Autoritetet kompetente do të garantojnë funksionimin e pandërprerë të pikave të kontaktit.

8. Palët do të njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën me shkrim për çdo ndryshim në organet kompetente dhe pikat e kontaktit.

### Neni 4

#### **Format e bashkëpunimit**

1. Në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje dhe në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar, Palët do të bashkëpunojnë mbi bazën e barazisë, reciprocitetit dhe përfitimit të ndërsjellë nëpërmjet:

a) dhënies së ndihmës dhe sigurimit të informacionit, sipas kërkesës në rast të fatkeqësive apo rrezikut të ndodhjes së fatkeqësisë;

b) shkëmbimit të informacionit, dokumentacionit tekniko-ligjor, literaturës metodologjike dhe llojeve të tjera, materialeve video dhe foto, që lidhen me parandalimin e fatkeqësive, gatishmërinë dhe reagimin, si edhe në funksion të përgatitjes së programeve të përbashkëta, për kërkimin shkencor dhe për vlerësimin e rreziqeve;

c) furnizimit të ekipeve të shpëtimit me pajisje;

d) organizimit dhe mbajtjes së takimeve të përbashkëta të ekspertëve, seminareve, konferencave dhe veprimtarive ushtrimore në fushën e mbrojtjes civile në nivele të ndryshme;

e) shkëmbimit të përvojave dhe praktikave të mira;

f) organizimit të shkëmbimit dhe të trajnimit të ekspertëve, duke përfshirë shkëmbimin e lektorëve dhe të trajnuesve nga qendrat përkatëse të trajnimit dhe institucioneve përfshirë dhe ato arsimore, me kërkesë të secilës Palë;

g) planifikimit të përbashkët, zhvillimit dhe zbatimit të projekteve dhe të punëve kërkimore në fushën e parandalimit të fatkeqësive, gatishmërisë dhe reagimit.

2. Autoritetet kompetente të Palëve, në përputhje me nenin 3, paragrafi 2, të këtij neni, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar: a) mund të formojnë grupe pune; b) mund të nxisin bashkëpunimin ndërmjet organizatave humanitare në operacionet e ndihmës dhe të kërkim-shpëtimit, në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera.

3. Palët do t'i japin njëra-tjetrës asistencë në rast fatkeqësie, brenda kapaciteteve të tyre.

4. Shpenzimet e shkëmbimit të ekspertëve, mbulohen nga Pala dërguese, përveç rasteve kur Palët bien dakord ndryshe.

#### Neni 5

### **Procedura për dhënien e ndihmës**

1. Pala që përballet me një fatkeqësi ka të drejtë të kërkojë ndihmë nga pala tjetër bashkëpunuese.

2. Kërkesa për ndihmë do të bëhet me gojë ose me shkrim nga pala kërkuese. Një kërkesë me gojë duhet të konfirmohet me shkrim. Kërkesa për ndihmë do të përmbajë:

a) llojin, shkallën, vendndodhjen, kohën dhe gjendjen aktuale të fatkeqësisë së Palës kërkuese;  
b) informacion mbi veprimin e ndërmarrë dhe të planifikuar për t'u përbashkuar me fatkeqësinë;  
c) llojin dhe përparësitë e ndihmës së kërkuar, për sa u përket ekipeve të shpëtimit dhe/ose ekspertëve, pajisjeve, si dhe artikujve të ndihmës.

3. Ndihma e ndërsjellët mund të jepet me ekipe, ekspertë, pajisje për kërkim-shpëtim dhe materiale humanitare.

4. Në çdo rast, veprimet operacionale të përbashkëta do të koordinohen nga strukturat kompetente të Palës Kërkuese.

5. Vetëm drejtuesit e ekipeve të Palës ndihmuese mund t'u japin udhëzime teknike ekipeve të tyre.

6. Pala Kërkuese (strukturat e saj kompetente apo një institucion tjetër i autorizuar) do të informojë drejtuesit e ekipit të ndihmës apo ekspertët rreth situatës në territorin e përfshirë nga fatkeqësia, do të përcaktojë vazhdimësinë e veprimeve dhe kur kërkohet, do të sigurojë përkthyes dhe shërbime e mjete të tjera të kërkuara për nevojat që kanë ekipet e ndihmës.

7. Pala Kërkuese do të kujdeset për sigurinë e ekipeve të ndihmës apo ekspertëve dhe sipas rastit do të sigurojë përkujdesje mjekësore emergjente, ushqim, akomodim, si edhe produkte bazë për ekipet dhe ekspertët, nëse ata harxhojnë furnizimet e tyre.

8. Pala Kërkuese do të sigurojë marrjen dhe përdorimin e ndihmës së dhënë pa pengesa dhe do të garantojnë se do të shpërndahet ekskluzivisht për qëllimin e saj specifik dhe falas.

9. Me kryerjen e detyrës së tyre ose më shpejt, nëse kjo kërkohet nga strukturat kompetente të Palëve të kësaj Marrëveshjeje, ekipet apo ekspertët e ndihmës do të largohen nga territori i Palës Kërkuese

10. Ekipet e shpëtimit dhe/ose ekspertët e dërguar për të dhënë ndihmë, si dhe pajisjet dhe artikujt ndihmës mund të transportohen nga toka, ajri apo uji. Shpenzimet e transportit mbulohen nga pala ndihmuese.

#### Neni 6

### **Procedurat e kalimit kufitar dhe rregullat për qëndrimin e ekipeve të shpëtimit dhe/ose të ekspertëve**

1. Pala kërkuese duhet të marrë gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar kalimin e kufirit nga ekipet e shpëtimit dhe/ose ekspertëve të palës ndihmuese.

2. Drejtuesi i ekipit të shpëtimit duhet t'u paraqesë zyrtarëve kufitarë dhe zyrtarëve doganorë të palës kërkuese dokumentet e mëposhtme, të certifikuara nga autoriteti kompetent i palës ndihmuese:

a) një dokument të plotësuar në formularin standard të miratuar nga autoritetet kompetente të Palëve, duke përcaktuar kompetencat e ekipeve të shpëtimit dhe/ose ekspertëve, si dhe qëllimin e ardhjes së tyre në territorin e palës kërkuese;

b) një listë të anëtarëve të ekipeve të shpëtimit dhe/ose ekspertëve dhe një listë të pajisjeve dhe të mjeteve;

c) një listë e artikujve të ndihmës.

3. Shoferët duhet të paraqesin lejet e drejtimit për automjetet përkatëse motorike dhe certifikatat e regjistrimit të tyre.

4. Procedura për kalimin e kufirit të palës kërkuese nga ekipet e shpëtimit me qen shpëtimi dhe qëndrimin e tyre aty brenda territorit të Palës në fjalë, përcaktohet sipas rregullave karantinore të Palës në fjalë.

5. Anëtarët e ekipit të shpëtimit mund të veshin uniformat e tyre në territorin e palës kërkuese. Ekipi i shpëtimit të Palës ndihmuese autorizohet që të përdorë shenjat e tij dalluese në mjeteve të tij në territorin e Palës kërkuese.

6. Procedura e kalimit kufitar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë nen, zbatohet për më tepër kur një nga Palët është shtet tranzit, në lidhje me një vend të tretë kërkuës ndihme, në rast fatkeqësie. Autoritetet kompetente të përmendura në nenin 3, paragrafi 2, të kësaj Marrëveshjeje do të njoftojnë njëra-tjetrën në kohën e duhur për nevojën e kalimit tranzit për dhënien e ndihmës në një vend të tretë dhe do të bashkërendojnë procedurën për tranzitin e pajisjeve dhe artikujt e ndihmës.

7. Në rastet e fatkeqësive përgjatë kufirit ndërmjet dy shteteve, palët ofrojnë ndihmën me ekipe dhe teknike edhe nëpërmjet kufirit të gjelbër, nën mbikëqyrjen e policive kufitare të të dyja shteteve.

## Neni 7

### **Kalimi kufitar i pajisjeve dhe i artikujve të ndihmës**

1. Palët garantojnë një procedurë të lehtësuar gjatë kalimit të kufirit të pajisjeve dhe të artikujve të ndihmës.

2. Anëtarët e ekipit të shpëtimit dhe/ose ekspertët e dërguar për të dhënë ndihmë nuk lejohen të mbajnë armë dhe municione në territorin e Palës kërkuese.

3. Mbi bazë reciprociteti, Palët bien dakord se pajisjet do të përdoren përkohësisht dhe pa pagesë në territorin e Palës kërkuese.

4. Kufizimet ose ndalimet e zbatueshme për kalimin kufitar të mallrave nuk zbatohen për pajisjet dhe për artikujt e ndihmës, sipas kësaj Marrëveshjeje, pa cenuar rregulloret në fuqi të BE-së dhe/ose rregulloret ndërkombëtare. Pajisjet duhet të kthehen nga pala kërkuese, përveç rasteve kur pajisja në fjalë është shkatërruar gjatë përdorimit të saj. Çdo pajisje e lënë si artikull ndihme përshkruhet hollësisht në një Protokoll të hartuar nga drejtuesi i ekipit të shpëtimit, duke specifikuar llojin, sasinë dhe vendin dhe certifikohet nga autoriteti kompetent i palës kërkuese të përmendur në nenin 3, paragrafi 2, të kësaj Marrëveshjeje. Autoritetet e mësipërme janë të detyruara të njoftojnë shërbimet doganore kompetente, me Protokollin që u dorëzohet zyrtarëve të kontrollit doganor, pas përfundimit të misionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi të Palës kërkuese.

5. Dispozitat e paragrafit të mësipërm zbatohen edhe për rastin kur ndihma e kërkuar nga Pala Kërkuese është në barna që përmbajnë substanca narkotike dhe psikotrope, si dhe për transportin e anasjellë të sasive të papërdorura. Çdo lëvizje e mallrave të tilla nuk trajtohet si import dhe eksport nga pikëpamja e marrëveshjeve ndërkombëtare për barnat që përmbajnë substanca narkotike dhe psikotrope. Medikamentet në fjalë mund të importohen vetëm në sasi të nevojshme për qëllime të kujdesit mjekësor dhe mund të përdoren vetëm nga personel mjekësor i kualifikuar në pajtim me legjislacionin e Palës kërkuese. Në rast të tillë, kreu i ekipit të shpëtimit u paraqet zyrtarëve kufitarë një deklaratë, duke renditur nomenklaturat dhe sasitë e barnave që

përmbajnë substanca narkotike dhe psikotrope. Etiketa e dukshme me njoftimin e qartë “përmban substanca narkotike” vendoset në paketat që përmbajnë barnat e lartpërmendura.

Drejtuksi i ekipit të shpëtimit do të hartojë një protokoll për çdo sasi të papërdorur, të cilat do të certifikohen nga autoriteti kompetent i Palës kërkuese të përmendur në nenin 3, paragrafi 2, të kësaj Marrëveshjeje, dhe do t’u paraqitet zyrtarëve të kontrollit doganor pas përfundimit të misionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi të Palës kërkuese.

6. Pala kërkuese mund të kontrollojë përdorimin dhe ruajtjen e barnave të lartpërmendura, pajisjeve dhe artikujve të ndihmës.

## Neni 8

### **Strehimi dhe ndihma e të zhvendosurve**

1. Personat të cilët në rast fatkeqësie kanë mbërritur si të shpërngulur nga territori i njëjës Palë në territorin e Palës tjetër do të pranohen nga palët deri në momentin e kthimit të tyre të parë të mundshëm dhe do t’u sigurohen nga Palët të gjitha shërbimet dhe ndihmat e nevojshme. Shpenzimet për dhënien e ndihmës dhe kthimi i këtyre personave do të mbulohen nga Pala ku ata kanë ardhur.

2. Palët do të mundësojnë kthimin e të gjithë personave që kanë ardhur si të shpërngulur në territorin e njëjës prej Palëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Shtetasit e evakuuar vendës dhe të huaj, të cilët kanë kaluar brenda territorit të Palës tjetër do të raportojnë menjëherë hyrjen e tyre të njësisë më e afërt e policisë, në përputhje me dispozitat ligjore që zbatohen për qëndrimin e shtetasve të huaj.

## Neni 9

### **Përdorimi i avionëve**

1. Avioni mund të përdoret për transportin e shpejtë të ekipeve të shpëtimit, sipas nenit 5, paragrafi 10, si dhe për sigurimin e ndihmës në rast fatkeqësie në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

2. Fluturimet e avionëve do të kryhen në përputhje me dispozitat e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO) dhe legjislacionit kombëtar të Palëve.

3. Avioni i përmendur në paragrafin e mësipërm mund fluturojë mbi territorin e Palës tjetër, si dhe mund të ulet dhe ngrihet jashtë aeroporteve ndërkombëtare dhe pistave të regjistruara, në vende të caktuara nga autoritetet kompetente të përmendura në nenin 3, paragrafi 2, në këtë dokument, në përputhje me rregullat e kryerjes së fluturimit për çdo rast të veçantë, sipas kuadrit ligjor të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës.

4. Organet e sigurisë të aviacionit dhe sigurisë të të dyja palëve do të njoftojnë njëra-tjetrën menjëherë për përdorimin e avionëve gjatë operacioneve të shpëtimit, duke siguruar të dhëna të sakta, në lidhje me llojin dhe numrin e regjistrimit të avionit, ekuipazhit, mallrave, kohën e nisjes dhe itinerarin e kërkuar dhe vendin e uljes.

5. Neni 6 i kësaj Marrëveshjeje zbatohet për ekuipazhin e avionit dhe për anëtarët e ekipit të shpëtimit të transportuar në këtë mënyrë.

6. Neni 7 i kësaj Marrëveshjeje zbatohet për avionët, pajisjet dhe artikujt e ndihmës të transportuar në këtë mënyrë.

7. Kalimi kufitar dhe kontrolli doganor i avionit kryhet nga zyrtarët kufitarë dhe të kontrollit doganor të palës kërkuese në vendin e uljes së avionit në fjalë.

8. Përdorimi i avionëve ushtarakë i nënshtrohet një miratimi të qartë me shkrim nga pala kërkuese.

## Neni 10

### **Bashkërendimi dhe menaxhimi i operacioneve të ndihmës ndaj fatkeqësisë**

1. Bashkëndimi dhe menaxhimi i operacioneve të ndihmave në raste fatkeqësish është përgjegjësi e autoritetit kompetent të Palës kërkuese.

2. Pala kërkuese do të informojë drejtuesit e ekipeve të shpëtimit dhe/ose ekspertët për zhvillimin e situatës në zonën e fatkeqësisë dhe në vendet e caktuara për veprimtari dhe do të sigurojë, kur është e nevojshme, mjete komunikimi me shtabin operacional.

3. Ekipet e shpëtimit dhe/ose ekspertet, si dhe pajisjet e tyre duhet të jenë të aftë të funksionojnë në mënyrë autonome dhe të pavarur brenda 24 orëve pas kohës së mbërritjes së tyre në zonën e fatkeqësisë.

#### Neni 11

### **Shpenzimet e operacioneve të ndihmës ndaj fatkeqësisë**

1. Pala ndihmuese nuk ka të drejtën e rimbursimit nga Pala Kërkuese të ndonjë prej shpenzimeve të bëra gjatë dhënies së ndihmës. Kjo zbatohet edhe për ndonjë nga shpenzimet e shkaktuara si rezultat i përdorimit, dëmtimit ose humbjes së pajisjeve, përveç rasteve kur dëmtimi ose humbja e pajisjeve është, për shkak vetëm të fajit me dashje të zyrtarëve apo qytetarëve të palës kërkuese. Për shpenzimet e shkaktuara si rezultat i përdorimit, dëmtimit ose humbjes së pajisjeve gjatë kryerjes së operacioneve të ndihmës, të mbahet një procesverbal i detajuar i cili të nënshkruhet nga drejtuesi i ekipit dhe anëtarët e tij.

2. Në rast se palët bien dakord për kompensimin e pjesshëm të shpenzimeve të përfshira në dhënien e ndihmës, dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni nuk do të aplikohen.

3. Pala ndihmuese do të lirohet nga pagesa e tarifave për fluturimet tranzit, uljet, ngritjet, pritjet dhe shërbimet ajro-portuale për nevoja të mjeteve të saj.

4. Në rastet kur mjetet ajrore përdoren për dhënien e ndihmës, strukturat kompetente të Palëve në çdo rast individual, bien dakord mbi kompensimin e shpenzimeve për furnizimin e tyre me karburant dhe mirëmbajtjen e tyre.

5. Nëse ekipet apo ekspertët e kërkim-shpëtimit, që marrin pjesë në dhënien e ndihmës i shpenzojnë rezervat e tyre, atëherë shpenzimet për sigurimin, akomodimin dhe materialet për nevojat e tyre, deri në përfundimin e misionit të tyre, do të mbulohen nga Pala Kërkuese.

6. Pala kërkuese i përballon shpenzimet e operacioneve të shpëtimit, që kryhen me kërkesën e saj nga persona fizikë ose juridikë, e cila është mundësuar nëpërmjet ndërmjetësimit të palës ndihmuese.

7. Pala kërkuese do të ofrojë siguri dhe mjekime falas për ekipet e shpëtimit dhe/ose ekspertët e dërguar nga pala ndihmuese, si dhe mbështetje logjistike për kohën e misionit të tyre.

#### Neni 12

### **Dëmet dhe kompensimet**

1. Pala ndihmuese do të heqë dorë nga çdo pretendim për dëmet që mund të lindin për Palën në fjalë ose për ndonjë ekspert të dërguar nga ana e saj për të dhënë ndihmë, në lidhje me:

a) ndonjë dëmtim të pronës të shkaktuar nga ekipet e shpëtimit ose ekspertë gjatë ekzekutimit të detyrave të tyre;

b) ndonjë dëmtim fizik, dëmtim të shëndetit ose vdekjen e një anëtari të një ekipi shpëtimi dhe /ose ekspert, të ndodhur gjatë zbatimit të detyrave të tij/të saj.

2. Nëse ndonjë anëtar i ekipit të shpëtimit dhe/ose eksperti i palës ndihmuese shkakton dëm ndaj një pale të tretë brenda territorit të Palës kërkuese gjatë kryerjes së aktiviteteve, sipas kësaj Marrëveshjeje, dëmet në fjalë do të mbulohen nga Pala kërkuese në bazë të legjislacionit të saj në fuqi, në të njëjtën mënyrë sikur një dëm tillë të ishte shkaktuar nga qytetarët e Palës në fjalë gjatë kryerjes së detyrave të tyre zyrtare.

3. Çdo dëmtim i shkaktuar nga cilido anëtar i ekipeve të shpëtimit dhe/ose ekspert me dashje apo nga pakujdesia e rëndë, do të mbulohet nga pala ndihmuese, me kusht që fakti i dëmit me keqdashje të jetë vërtetuar në gjykatën kompetente të palës kërkuese.

4. Palët do të ndërveprojnë sipas nenit 3 të këtij ligji dhe legjislacionit të tyre në fuqi, për të lehtësuar zgjidhjen e çdo kërkesë për dëmet dhe kompensimet. Palët në fjalë do të shkëmbejnë të gjithë informacionin në dispozicion në të gjitha rastet e dëmeve brenda kuptimit të dhënë në këtë nen.

#### Neni 13

### **Komunikimi gjatë operacioneve të ndihmës ndaj fatkeqësisë**

Autoritetet kompetente të përmendura në nenin 3, paragrafi 2, të kësaj Marrëveshjeje garantojnë të gjitha masat e nevojshme për krijimin e komunikimit të besueshëm për nevojat e ekipeve të shpëtimit dhe/ose ekspertët në vendin e operacioneve të ndihmave në raste fatkeqësish.

#### Neni 14

### **Ndërprerja e operacioneve të ndihmës ndaj fatkeqësisë**

Ekipet e shpëtimit dhe/ose ekspertët do të ndërpresin aktivitetet e tyre menjëherë pas kërkesës me shkrim nga ana e autoritetit kompetent të Palës kërkuese të përmendur në nenin 3, paragrafi 2, ose kur qëllimi i ndihmës ka përfunduar.

#### Neni 15

### **Përdorimi i informacionit**

I gjithë informacioni i mbledhur si rezultat i aktiviteteve të kryera, në përputhje me këtë Marrëveshje, mund t'u jepet palëve të treta dhe publikut, vetëm në bazë të miratimit të dhënë më parë nga Palët e kësaj marrëveshjeje, duke marrë në konsideratë dispozitat e ligjeve të aplikueshme të shteteve përkatëse.

#### Neni 16

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje në interpretimin apo në zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje që nuk mund të zgjidhet nëpërmjet konsultimeve dhe bisedimeve ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve, zgjidhet nëpërmjet kanaleve diplomatike.

#### Neni 17

### **Lidhja me marrëveshjet e tjera ndërkombëtare**

Kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtat dhe detyrimet ekzistuese të Palëve, që rrjedhin nga marrëveshjet e tjera ndërkombëtare të lidhura ndërmjet tyre dhe/ose në të cilat ato janë Palë.

#### Neni 18

### **Hyrja në fuqi**

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e fundit të marrjes së njoftimeve, nëpërmjet të cilave Palët informojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave kombëtare të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.



2. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet dhe të plotësohet me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve, me anë të protokolleve shtesë. Protokollet shtesë në fjalë do të jenë pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje dhe do të hyjnë në fuqi, në përputhje me procedurën e caktuar për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

3. Kjo Marrëveshje do të lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe. Secila Palë mund të denoncojë efektin e saj, duke i dërguar një njoftim me shkrim Palës tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Çdo denoncim i tillë do të hyjë në fuqi gjashtë muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga Pala tjetër.

Bërë në Tiranë, më 2.10.2020, në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, një për secilën palë.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE  
TË REPUBLIKËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
OLTA XHAÇKA  
MINISTËR

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
AGIM VELIU  
MINISTËR